



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:129426

Datë: 13.04.2023

Numri i dokumentit: 04186023

**C.nr.1187/18**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shaban Shala, në kontestin e paditeses A. (L) D. nga fshati .... Komuna e Gjakoves, kundër të paditurit F. (F) J. nga fshati .... Komuna e Prizrenit të cilin e përfaqëson av.B.Q. nga Ferizaji për shkak të kompensimit të dëmit me vlerë të kontestit 5,000.00 euro, me datën 13.04.2023 mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditeses në këtë çështje juridike kontestimore.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

#### **A r s y e t i m**

Paditësja A. (L) D. nga fshati ... Komuna e Gjakoves, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit F. (F) J. nga fshati .... Komuna e Prizrenit të cilin e përfaqëson av.B.Q. nga Ferizaji për shkak të kompensimit të dëmit me vlerë të kontestit 5,000.00 euro.

Në shqyrtimin përgatitor të dt.13.04.2023 ka prezentuar paditësja personalisht e cila shprehimisht ka deklaruar se e tërheqë padinë për shkak se me të paditurin nuk dëshiron të ketë punë ngase jetën faktike bashkëshortore e kanë ndërprerë që 5 vite.

Duke marrë parasysh këtë fakt se paditësja e ka tërhequr padinë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 261 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i Përgjithshëm-**  
**C.nr.1187/18, më datë 13.04.2023**

**Gjyqtari**  
Shaban Shala

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në bazë të nenit 261.4 të LPK-së.